



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 56, datë 24 .12. 2012

**PËR
“RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË DISA INSTITUCIONEVE
NË VARËSI TË BASHKISË SË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 32, shkronja “ç”, nenit 33, pika 6 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar); nenit 121, pika 1, nenit 124, pika 1, nenit 125, nenit 126, pika 1 dhe nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 për “Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 për “Mbrojtjen e Konsumatorit”, vendimin e Këshillit Bashkiak nr.10, datë 12.10.2011, për “Krijimin e Agjensisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Tiranë”, vendimin e Këshilli Bashkiak nr.21, datë 10.11.2011 për “Riorganizimin e strukturave organizative të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, vendimin e Këshillit Bashkiak nr.38, datë 09.10.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në strukturat organizative të disa ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë si më poshtë:
 - a. “Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit”, sipas organogramës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b. “Drejtorisë së Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit”, sipas organogramës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c. “Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”, sipas organogramës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d. “Agjensisë për Mbrojtjen e Konsumatorit”, sipas organigramës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Pika 2 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 12.10.2011 për “Krijimin e Agjensisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës”, pika 1, shkronja “a” dhe “b” e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.21, datë 10.11.2011 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës”, pika 1 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.38, datë 09.10.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”, revokohen.
3. Efektet financiare për paga dhe sigurimet shoqërore do të përballohen nga buxheti i vitit 2013 i Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, dhe Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI